

Politika e privatësisë së Gjykatës së Apelit të Gostivarit

Kjo politikë e privatësisë ofron informacione të përgjithshme për përpunimin e të dhënave personale kur vizitoni faqet tona të internetit www.sud.mk dhe/ose përdorni disa nga shërbimet tona përmes tyre. Ne mbledhim vetëm ato të dhëna personale që janë të nevojshme për të pëmbushur detyrat dhe kompetencat tona ligjore.

Gjykata e Apelit në Gostivar ndërmerr të gjitha masat e nevojshme teknike dhe organizative për të mbrojtur nga qasja dhe përdorimi i paautorizuar i të dhënave personale të përdoruesve të saj dhe subjekteve për të cilat ruan/përpunon të dhënat, në përputhje me rregullat ligjore dhe aktet nënligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale.

Kontrolluesi i mbledhjeve të të dhënave Personale

Kontrolluesi i të dhënave personale është Gjykata e Apelit Gostivar, me seli në rrugën Zhivko Brajkoski nr.1, Gostivar, Republika e Maqedonisë së Veriut, Telefon: 042 221 544, E-mail: info@asgostivar.mk

Të dhënat e të cilit mbledhim

- Vizitorët e faqes sonë www.vsm.mk

Ne zakonisht mbledhim të dhëna që përdoren për të ruajtur sigurinë e informacionit të faqeve tona të internetit.

- Përdoruesit që bëjnë pyetje ose paraqesin ankesa

Këto pyetje/ankesa përmbajnë informacion në lidhje me identitetin e aplikantit.

- Përdoruesit që kërkojnë qasje në informacionin me karakter publik

Për të proceduar kërkesat për qasje në informacione të karakterit publik, aplikuesit kërkohet që të dorëzojnë të dhënat në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informacione të Karakterit Publik.

- Përdoruesit e Shërbimit të Sistemit të dorëzimit elektronik të dokumenteve gjyqësore me profil përdoruesi

Për të hapur një profil përdoruesi, aplikanti paraqet të dhëna personale që janë të nevojshme për të vepruar në përputhje me kompetencat ligjore të gjykatave.

Kategoritë e të dhënave të përpunuara

- Të dhënat nga vizitat në ueb faqe

Kur vizitoni faqen e internetit të Gjykatës së Apelit të Gostivarit, automatikisht krijohen shënime në regjistrat për çdo qasje individuale nga përdoruesi, të cilat mund të përmbajnë informacione për:

- Data dhe ora e hyrjes;
- Adresa IP;
- Pajisja nga e cila akseson përdoruesi, lloji dhe modeli;

- Sistemi operativ;
- Lloji i kërkimit;
- Faqet që përdoruesi viziton në faqet tona të internetit;
- Shteti (përcaktohet përmes adresës IP).

- Të dhënat që përdoruesit paraqesin vullnetarisht

• Përdoruesit pa profil përdoruesi - kur bëjnë pyetje, parashtrojnë ankesa ose kërkojnë qasje në informacione publike, përdoruesit paraqesin vullnetarisht të dhënat e identitetit të kërkuesit. Mund të mbledhim disa nga kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale: emrin dhe mbiemrin, adresën, numrin e telefonit të kontaktit dhe emailin. Ato automatikisht dërgohen në adresën elektronike të zyrtarëve përgjegjës në Gjykatën e Apelit Gostivar dhe procedohen në përputhje me rregulloret ligjore.

• Përdoruesit me profil përdoruesi - për këta përdorues, përveç detajeve teknike, regjistrohen edhe të dhënat e nevojshme personale për krijimin e profilit. Për të shfrytëzuar shërbimin e ofruar nga Gjykata e Apelit në Gostivar, kërkohet vërtetimi përkatës (konfirmimi i identitetit të përdoruesit) dhe autorizimi përkatës (përcaktimi i të drejtave - autorizimet për përdorim).

Si mbledhim të dhëna personale

Ne mbledhim të dhëna personale përmes kanaleve të ndryshme, duke përfshirë:

- përmes formularëve për pyetje, ankimim, akses në informacione publike dhe formularë për regjistrimin si përdorues të Sistemit për dorëzim elektronik të dokumenteve gjyqësore duke krijuar një profil përdoruesi.
- nëpërmjet adresave të emailit të kontaktit të disponueshme në faqen e internetit
- nëpërmjet postës

E drejta për të paraqitur kërkesë në AMDHP

Nëse mendoni se mënyra se si Gjykata e Apelit të Gostivarit i përpunon të dhënat tuaja personale bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mund të parashtroni kërkesë në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si organ mbikëqyrës, që do të veprohet në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ndryshimi i politikës së privatësisë

Politika e privatësisë do të ndryshohet dhe plotësohet rregullisht sipas ndryshimeve dhe aktiviteteve tona.